

Numri i lëndës: 2023:049144

Datë: 21.08.2023

Numri i dokumentit: 04600118

**A.nr.412/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti Për Çështje Administrative**, me gjyqtaren Liridona Ajeti Kajtazi, me sekretare juridike Nazife Sheholli, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditësit L. K.-Pejë, përfaqësuar nga avokat H. S.-Prishtinë, kundër të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, përfaqësuar nga F. G., në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur me prezencën e përfaqësueseve të palëve ndërgjyqëse, me datë 17.08.2023 merr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit L. K.-Pejë, kundër të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.
- II. ANULOHET** vendimi i të paditurës A.nr.622/2022 datë 26.01.2023 dhe çështja i kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.
- III. DETYROHET** e paditura që të udhëzojë palën paditëse se në cilin organ/institucion të drejtohet në lidhje me realizimin e të drejtës së tij, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.

### **A r s y e t i m**

Padit me padinë e datës 24.02.2023 ka kërkuar anulimin e vendimit A.nr.622/2022 të të paditurës si dhe vendimin nr.411/2022 të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, të mbetet në fuqi vendimi nr.627/13 dhe të të gjitha gjitha vendimet që rrjedhin nga ky emërim, si dhe vendimi nr.135, të obligohet Sekretari i Përgjithshëm i MPJD që nga data 30.06.2022 e deri në zbatimin e aktgjykimit paditësit ti kompensoj pagat dhe benificionet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës bazuar në vendimin nr.135 datë 14.03.2022 përfshirë dhe kumatën prej 8 % në zbatim të plotë të këtij aktgjykimi.Gjatë shqyrtimit gjyqësor përmes përfaqësuesit me autorizim ka theksuar se mbetem prapa padisë dhe kërkesës së saj, konsiderojmë që vendimi i Këshillit i dt.26.01.2023, është një vendim i cili është nxjerr në kundërshtim me vet mandatin dhe funksionin e KPMSHCK, për arsye se KPMSHCK ka për mandat që të shqyrtoi ankesat e nëpunësve civil, e që në këtë rast shpallja e in kompetencës për anëtarët e personelit diplomatik të cilët edhe ne bazë të Ligjit të SHC, i cili ka qenë në fuqi në kohën e emërimit të paditësit por edhe në bazë të Ligjit për Ministrin e Punës së Jashtme dhe Shërbimit Diplomatik, kanë statusin e nëpunësit civil, madje është e

habitshme se si KPMSHCK, shpall veten in kompetente për trajtuar ankesën e paditësit, ku që nga themelimi i saj e respektivisht nga viti 2010 e këtej kur ka hyrë në fuqi LSHC, në baza të rregullta vjetore ka monitoruar misionet diplomatike të Republikës së Kosovës, për të vlerësuar zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil në këto misione, e ku këto misione dihet mirëfilli që janë të punësuar personel diplomatik dhe konsullor siç ishte rasti edhe me paditësin. Andaj shpallja e in kompetencës konsiderojmë që është në kundërshtim me legjislaturën në fuqi dhe Këshilli në këtë rast ka dështuar që të ushtroi mandatin e tij kushtetues dhe ligjor. Sa i përket arsytimit të vendimit të Këshillit i cili vendimmarrjen e bazon në një fakt për ne pa qenë, respektivisht kur thotë se paditësi nuk ka akt emërim dhe është i emëruar politik, nga kjo shihet se Këshilli gjatë kësaj vendimmarrje nuk e ka analizuar në mënyrë të tërësishme legjislacionin e veçantë që ka të bëjë me nëpunësit e Ministrisë së Punës së Jashtme që ka të bëjë me misionet diplomatike, duke anashkaluar kështu një fakt qenësor siç është procedura e zhvilluar në vitin 2012 dhe siç është dispozita e nenit 2 të Ligjit 03-L207, për plotësim ndryshimin e Ligjit 03 L044 për MTJ në shërbimin diplomatik, dispozitë e cila kjo në mënyrë të qartë e rregullon se kush është i emëruar politik në shërbimin e jashtëm, të emëruar politik mund të jenë vetëm shefat e misioneve “Ambasadorët dhe konsujt të përgjithshëm” dhe atë vetëm në masën prej 50% e pozitive të ambasadorëve dhe konsujve, ndërsa të gjithë personeli tjetër diplomatik janë diplomat të karrierës, të cilët emërohen përmes procedurave të përcaktuara në Ligjin dhe shërbimin e jashtëm, procedurë kjo e cila është ndjekur në rastin e emërimit të paditësit. Kjo është pak a shumë rreth çështjes të jo kompetencës së Këshillit, në aspekt të trajtimit të legjislacionit të veçantë, i cili në mënyrë të pavarur i trajton procedurat e rekrutimit për persona diplomatik dhe është i pa qëndrueshëm konstatimi i Këshillit, se gjatë procedurës kur është emëruar paditësi nuk janë zbatuar dispozitat e Ligjit të shërbimit civil dhe Rregullorja 02/2010, për rekrutimin e shërbyesve civil. Kjo për arsye se legjislacioni i veçantë në mënyrë decisive dhe taksative e përcakton se Ministria e Punëve të Jashtme procedurat me akt nënligjor do të rregulloi procedurat e personelit diplomatik, ku mbi bazën e kësaj dispozite ministria kishte nxjerr UA në vitin 2009 dhe plotësuar në vitin 2012 për këto procedura dhe i cili Udhëzim në mënyrë të detajuar e përshkruan të gjithë procedurën që do të ndiqet për emërim. Në asnjë dispozitë të tillë të këtyre Udhëzimeve nuk shkruan se për çështjen të cilat nuk i rregullohen në këtë Udhëzim Ministria do ti referohet Rregullores 02/2012, e cila do të mund ti japë të drejtë pastaj një vlerësimi të tillë siç e ka bërë KPMSHCK, andaj mbi këtë bazë konsiderojmë se KPMSHCK është organ kompetent për trajtimin e paditësit dhe i njëjti do të duhej që të trajtonte atë. Nga aspekti formalo-juridik si ka mundësi që një organ përfundimtar në procedurën administrative ta mban lëndën 3 muaj ose më tepër dhe në fund të afatit vendimmarrës të nxjerr vendim për jo kompetencën LPPA e përcakton në mënyrë të sakët organi që e shqyrton ankesën që në momentin e pranimit të saj, nëse nuk është kompetent duhet ta shpallë atë dhe t'ia delegoi organit kompetent, e që edhe në këtë rast KPMSHCK në rastin e vendimit kontestues ka bërë shkelje të Ligjit si dhe dispozitave të Ligjit, pasi që palën e ka udhëzuar në gjykatë e jo të dërgoi lëndën tek organi kompetent nëse e ka ditur kush është kompetent nëse Këshilli nuk është kjo është sa i përket ndërmarrjes së këshillit. Sa i përket pretendimeve lidhur me vendimin e Ministres, qëndrojmë në tërësi pranë asaj që është shkruar në padi dhe kërkojmë nga gjykata e

nderuar që të trajtoi secilin pretendim veç e veç dhe të vendos në mënyrë meritore. Ajo çfarë desha të shtoi jashtë padisë është edhe një fakt shtesë që as Ministria e Punëve të Jashtme dhe as KPMSHKCK nuk e kanë marrë për bazë fare gjatë trajtimit të rastit të paditësit, e që është neni 83 par. 4 i Ligjit të nr.06 L-114, për zyrtarët publik i cili e ka përcaktuar se, nëse një punëtor aktual që mban një pozitë e cila është pozitë e shërbimit civil sipas këtij Ligji i cili nuk i përmbush kushtet e përcaktuara të nenit 8 të këtij Ligji, do të jetë në punë provuese dhe subjekt i dispozitave të punëve provuese në pajtim me këtë Ligj, çfarë do të thotë kjo, çfarë do të thotë neni 8, i cili e përcakton se të cilat kërkesa duhet të respektohen në pranimin e zyrtarëve publik, kërkesa këto të cilat janë respektuar sipas legjislacionit në fuqi në vitin 2012, siç janë vendimi për shpallje të konkursit, shpallja e konkursit publik, zhvillim i procedurës së listës së ngushtë, testimi me shkrim, intervista me gojë, testimet për gjuhë të huaja si specifik për pranimin e personelit diplomatik dhe vendimi për emërimin e kandidatit të suksesshëm, andaj mbi këtë bazë edhe sikur çdo të shkonte në kundërshtim me legjislacionin në fuqi që ka qenë në atë kohë prapë kjo dispozita tranzitore e LZP nuk ia lejon institucioneve që të largojnë shërbyes diplomatik nga puna, aq më tepër që paditësi në dosjen që e kam dorëzuar edhe në gjykatë, ka pasur edhe akt emërimi nga misioni diplomatik, akte këto të cilat nuk ka të drejtë dhe kompetencë Ministria ti shfuqizoi. Kërkoj nga gjykata që të aprovohet si e bazuar padia dhe kërkesëpadia si e bazuar, të anulohet vendimi i dt.26.01.2023, i KPMSHKCK-së, si dhe vendimi nr.ref.411/2022, i dt.30.06.2022 i nxjerr nga Ministria e Punës të Ministrisë së Punëve të Jashtme, të mbetet në fuqi vendimi me nr. ref.627/13, lidhur me emërimin e paditësit anëtar i shërbimit të jashtëm, dhe të gjitha vendimet e më pasme që rrjedhin nga ky vendim si dhe vendimi i fundit nr.ref.135/ me të cilin paditësi ishte caktuar me gradën diplomatike Këshilltar në Republikën e Kosovës në SHBA, po ashtu në këtë padi kemi edhe efektin për kompensim dhe lidhur me kompensimin e shtesave dhe beneficioneve që i ka rrjedhë nga marr. E punës bazuar në vendimin 135/22, duke përfshirë edhe kamatën ligjore prej 8%. I kundërshtoi tërësisht si të pa bazuara konstatimet e përfaqësuesit të Këshillit, sa i përket çështjes që palët nuk kanë ofruar dëshmi lidhur me se kanë përfunduar procedura, për faktin se është e habitshme se si kandidatët në këtë rast edhe paditësi ka sjellë më shumë dëshmi dhe prova, për procedurën e rekrutimit të kryer në vitin 2012, se sa vet institucioni i cili e ka zhvilluar procedurën. Po të shihni në dosjen e lëndës e vëreni se MPJD ka pru si prova lidhur me këtë konkurs tri dokumente vendimin e shpalljes së konkursit, shpalljen publike të konkursit dhe listën e kandidatëve aplikues në këtë konkurs, ndërkohë që paditësi ka sjellë ftesën për intervistë të gjuhëve të huaja, ftesën me shkrim, ftesën për intervistën me gojë, njoftimin për emërim të tij dhe vendimin për emërim dhe shtrohet pyetja logjike çka po fsheh MPJ në këtë rast kur ofron, si institucion që është i obliguar në ruajtjen e dosjes-aktiven në dosje të rekrutimit, e ofron atë në mënyrë të përsëritshme, e që te ne me të drejtë lindë dyshimi se fshehja e atyre provave është krejtësisht në qëllim dhe në përputhje me lënë në fuqi të vendimmarrjes së Ministres. Për më tepër kundërshtoi edhe konstatimin e përfaqësuesit të Këshillit, ku thotë se Këshilli nuk është shpallur jo kompetent për personelin diplomatik, por vetëm për paditësin, konstatim ky i cili nuk qëndron për shkak se tani është fakt notor, se janë përmbi 30 anëtar diplomatik, për të KPMSHKCK ka nxjerr vendim për in kompetencë të trajtimit të ankesave të tyre, pra nuk është rast i izoluar, kemi të

bëjmë me një numër të madh diku prej 30% të stafit diplomatik të cilat Këshilli ka vendos jo kompetencën e tij. Për më tepër kemi edhe një mendim mos pajtues të cilin e ka dhënë njëri nga anëtarët e Kolegjit, e që është kryetar i KPMSHCK i cili në mendimin si mos pajtues, ka konstatuar se Këshilli është kompetent për ti trajtuar ankesat e tyre dhe në trajtim të procedurës ankimore të paditësit i ka aprovuar të gjitha pretendimet dhe ka nxjerrë Aktvendim me të cilin i ka aprovuar ankesën dhe e ka obliguar Ministrinë e Punëve të Jashtme që paditësin ta kthej në vendin e punës, e që besoj që edhe gjykata e nderuar ti kushtoi vëmendje te veçantë vendimit mos pajtues, pasi që edhe pas legjislacionit të KOPMSHCK vendimi mos pajtues duhet ti jepet publicitet i njëjtë sikurse edhe vendimit të shumicës vendimmarrëse. Në fjalën përfundimtare ka theksuar se mbetem pranë padisë dhe kërkesëpadisë, si dhe prapa deklarimeve në shqyrtimin gjyqësor, konsiderojmë se edhe gjatë këtij shqyrtimi se Vendimi i Këshillit është nxjerr në kundërshtim me Ligjin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil dhe si i tillë i njëjti duhet të anulohet, dhe gjykata të marr vendim meritor, ashtu siç e kemi potencuar edhe në deklarin më lartë. .

Pala e paditur në përgjigje në padi, ka theksuar mes tjerash se e paditura nuk është kompetent për të shqyrtuar ankesën të këtij paditësit. Gjatë shqyrtimit gjyqësor përmes përfaqësuesit me autorizim mes tjerash ka theksuar se mbetem pranë përgjigjes në padi, se vendimi i Këshillit A.nr.622/2022, i dt.26.01.2023, është vendim i drejtë dhe i ligjshëm pasi që ka konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë dispozitat e ligjit material sikurse i kundërshtojmë pretendimin apo qëndrimin e përfaqësuesit të palës paditëse, se Këshilli është shpallur jo kompetent për shërbimin e jashtëm diplomatik ky konstatim është i pa qëndrueshëm, nga se në rrethanat e rastit konkret ne jemi shpallur jo kompetent për paditësin L. K., Këshilli ka mandat ligjor ti trajtoi ankesat e të punësuarve në Shërbimin e Jashtëm Diplomatik, me kushtin që të njëjtit ta kenë fituar statusin e nëpunësit civil siç përcaktohet me dispozitat ligjore në fuqi për shërbimin civil madje këshilli ka trajtuar ankesa dhe nëpunësve civil që kanë qenë pjesë e shërbimit të jashtëm diplomatik, ku të njëjtit kanë pasur edhe grada diplomatike madje në disa raste avokati është apo ka qenë përfaqësues i atyre ankuesve në këshill, prandaj po e ri theksoi se nuk është e qëndrueshme që Këshilli është shpallur jo kompetent për të trajtuar ankesat të punësuarve në Shërbimin e Jashtëm Diplomatik, nga rrjedhë se Këshilli do të bëjë monitorimet nëpër misionin diplomatike për ata zyrtar që e kanë statusin e nëpunësve civil. Po e ri theksojmë se Këshilli me aktin e kontestuar në këtë procedurë nuk e ka mohuar faktin se ankuesi ka pasur akt administrativ sikurse pala pretendon. Madje është elaboruar në arsyetimin e këtij akti dhe është administruar si provë, mirëpo ankuesi themelimin e marrëdhënies së punës në Shërbimin e Jashtëm Diplomatik e ka lidhur sipas vendimit të dt.30.12.2023, të nxjerr nga Ministri i Punëve të Jashtme, ndërsa e gjithë kronologjia e sistemimit të tij apo emërimit në pozita të ndryshme kanë rrjedhë pas këtij Vendimi të Ministrisë së Punëve të Jashtme i cili titullohet Vendim për emërim dhe caktim të gradës diplomatike, andaj dua të potencoi faktin se procedurat e rekrutimit në shërbimin civil nuk përcaktohen askund se përfundojnë me vendime të tilla me vendim dhe përcaktim të gradës diplomatike, por nëpunësit civil emërohen në shërbimin civil pas përfundimit të procedurave të rekrutimit dhe konfirmohen me akt emërim. Në rrethanat të cilat i referoi avokati, ne kemi konstatuar se ka qenë një konkurs i

hapur i dt.22.07.2011, i cili nuk është përmbyllur të paktën me prova nuk kanë arritur ta dëshmojnë palët e përfshira në procedurë pranë Këshillit, ndërsa diferenca në mes këtij konkursi dhe emërimit të ankuesit në Shërbimin e jashtëm diplomatik, është mbi dy vite e pesë muaj, andaj konstatoi se Këshilli ka vendosur drejtë kur është shpallur jo kompetent për rastin konkret. sa i përket çështjes që ne jemi shpallur jo kompetent për komplet shërbimin diplomatik, është i pa qëndrueshëm sepse shërbimi diplomatik nuk përbëhet vetëm nga ata 30 zyrtar të cilëve avokati i referohet sepse shërbimi është shumë më i gjerë se kaq, ndërsa sa i përket Vendimit mos pajtues konfirmoi se është dokument zyrtar, i nxjerr ose i dhënë nga njëri prej anëtarëve të Kolegjit, e që rezulton të jetë edhe Kryetar i Këshillit mirëpo sipas legjislacionit në fuqi vendimet merren me shumicë votash që në rastin konkret është prej dy anëtarëve me shumicë, ndërsa kolegji dhe unë kam autorizim të mbroj vendimin e këshillit. Në fjalën përfundimtare ka theksuar se mbetem në tërësi pranë përgjigjes në padi, deklarimeve në këtë seancë, se Vendimi i këshillit është nxjerr në pajtueshmëri me legjislacionin e këshillit dhe Ligjin material dhe kërkojmë nga gjykata që të konstatoi ligjshmërinë e tij, ndërsa të refuzoi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata, me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 17.08.2023, ka bërë administrimin e provave dhe atë: Procesverbal dt.20.05.2022, mendim mos pajtues An.r.622/22, i dt.26.01.2022, a.NR.365/22, DT.10.06.2022, vendim A.nr.263/22 dt.19.04.2022, vendim dt.20.05.2021, vendim A.nr.622/22, dt.26.01.2023, vendim i dt.30.12.2013, vendim i dt.20.09.2016, akt emërim i dt.08.11.2016, vendim i dt.14.03.2017, ndrysim dhe plotësim i akt emërimit dt.17.03.2017, vendim i dt.30.03.2018, vendim i dt.26.11.2018, note verbale 20.09.2020, vendim i dt.14.03.2022, vendim 02.03.2022, vendim i dt.30.06.2022, komunikim Elektronik 02.02.2012, 07.02.2012, 30.01.2012, 02.06.2012, 27.01.2012, 09.02.2012, 30.01.2012, 25.07.2022, 18.10.2022, njoftim për intervistë, dt.e kopjet 12/16/21, ankesë dt.15.07.2022, vendim i dt.29.08.2022, përgjigje 02.08.2022, vendim i dt.21.07.2011, lista e kandidatëve aplikues për misione diplomatike, vendim 365/22 dt.10.06.2022, njoftim i dt.18.10.2022, aktvendim i dt.19.08.2022, aktvendim i dt.29.09.2022, ankesë e dt.13.09.2022, ankesë e dt.30.08.2022, aktvendim i dt.20.10.2022.

Me vendimin A.nr.622/2022 datë 26.01.2023, e paditura shpallet jo kompetente për të vendosur për ankesën me A.nr.622/2022 datë 15.07.2022 të këtij paditësit. Paditësi i pakënaqur me këtë vendim, ka parashtruar padi në gjykatë duke kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në raport me dispozitat procedurale të përcaktuara në LKA-në, konkretisht nenin 44, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata kishte parasysh edhe nenin 75 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet : *''Kur një organ publik merr një kërkesë me shkrim që është jashtë kompetencave të veta pa vonesë do t'ia kaloj kërkesën organit kompetent dhe do të njoftoj dërguesin për këtë''*,

kurse neni 126 i këtij ligji përcakton: ''2. Çdo kërkesë, edhe në qoftë se nuk shënohet shprehimisht si ankesë, do të konsiderohet e tillë, në qoftë se qëllimi i palës për të kundërshtuar një akt apo heshtje administrative është mjaftueshëm i qartë''.

Po ashtu, gjykata konstaton se me vendimin e atakuar e paditura ka shpallur vetën jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e paditësit, kurse nuk ka zbatuar dispozitat e lartcekura, pra nuk ka referuar lëndën tek organi kompetent për të vendosur dhe nuk ka njoftuar palën paditëse në lidhje me këtë çështje.

Gjykata obligon të paditurën KPMSHCK-në në ri procedurë që fillimisht në raport me shkresat e lëndës dhe në përputhshmëri me dispozitat ligjore të vlerësoj fillimisht kompetencën e saj për shqyrtimin e ankesës dhe pastaj nëse gjen se e njëjta nuk ka kompetencë për shqyrtimin e ankesës së këtui paditësit të referoj ankesën e palës paditëse në institucionin/orgenin kompetent me qëllim që të realizojë të drejtën e tij, po ashtu e paditura duhet ta këtë parasysh edhe nenin 11 par 1 dhe 2 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se:

*''1. Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që mosdija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave juridike, që ajo ka sipas ligjit. Organi publik, në veçanti, informon palën për të drejtat dhe detyrimet e saj në procedurën administrative, si dhe për pasojat juridike të veprimeve a mosveprimeve të saj gjatë kësaj procedure.*

*2. Organi publik, gjatë procedurës administrative, ndihmon që palët të mbrojnë dhe realizojnë të drejtat dhe interesat e tyre juridike, sa më lehtë të jetë e mundur por pa cenuar të drejtat dhe interesat juridik të personave të tjerë''.*

Gjykata fillimisht konstaton se ka vlerësuar ligjshmërinë e vendimit përfundimtar administrativ se kuptim të nenit 9 të LKA-së andaj çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te e paditura, në raport me kërkesat e përfaqësuesit të paditësit për vendosje në merita të çështjes , anulimin e vendimit të MPJD, lënien në fuqi të vendimit nr.627 si dhe caktimin e detyrimit për sekretarinë MPJD lidhur me kompensimin e pagave shtesave dhe benificioneve nga marrëdhënia e punës, Gjykata konstaton se në këtë procedurë të konfliktit administrativ organi administrativ MPJD nuk është palë e ka paditur me padi, andaj dhe kërkesa për anulimin e vendimit të këtij organi administrativ dhe caktimin e obligimin për këtë organin administrativ, përderisa ky organ administrativ nuk është palë e paditur në këtë procedurë të konfliktit administrativ dhe se të njëjtit nuk i është dhënë mundësia asnjëherë të deklarohet (sepse nuk ishte palë e paditur në këtë procedurë), ishte në kundërshtim me nenin 20 të LKA-së ku përcaktohet se :'' Palë e paditur në konfliktin administrativ është organi, akti i të cilit kontestohet, përkatësisht organi i cili sipas kërkesës së palës ose ankesës së saj nuk e nxjerrë aktin në afatin e caktuar ligjor dhe të njëjtin nuk ia dërgon palës''.

Gjykata kishte parasysh edhe deklarimin e të paditurës si në përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor por gjykata ka vlerësuar se pretendimet e të paditurës, janë të pa bazuar dhe në kundërshtim me gjendjen faktike, për faktin se as në vendimin kontestues, as në pretendimet si në përgjigje në padi nuk ka argumentuar, pra e paditura nuk ka dhënë vlerësim apo arsyetim me vendimin kontestues sipas bazës ligjore dhe provave në të cilat e mbështet vendimin.

Gjykata si rregull konfliktin administrativ e vendos në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i atakuar me padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Andaj bazuar në të lartcekurat, në kuptim të nenit 5,6, 38, 43.3 si dhe nenit 46.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Çështje Administrative**  
**A.nr.412/2023, me datë 17.08.2023**

**Sekretare Juridike**  
Nazife Sheholli

**G j y q t a r e**  
Liridona Ajeti Kajtazi

**KËSHILLË JURIDIKE:** *Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.*